Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0041

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vjosa Gradinaj Mexhuani si paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" kundër njoftimit për dhënie të një kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizike i objekteve" me nr. te prokurimit: 661-23-13525-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Ranillug më 22/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" e datës 11.01.2024, me nr.protokolli 2024/41, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizike e objekteve" me nr. te prokurimit: 661-23-13525-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Ranillug.

2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues -Komuna Ranillug lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 04.12.2023, Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues [AK] ka publikuar Njoftimin për Kontratë [NJK] lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizike i objekteve" me nr. te prokurimit: 661-23-13525-2-2-1. Ndërsa me datë 28.12.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate "SAS" SH.P.K.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës : 60,000.00 €.

Me 31.12.2023, OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 04.04.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 11.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" me nr. 41/2024 lidhur me aktivitetin "Sigurimi fizike e objekteve" me nr. te prokurimit: 661-23-13525-2-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Autoriteti Kontraktues, Komuna Ranillug, ka zbatuar procedurën e hapur të prokurimit për një kontratë me shërbime me vlerë të parashikuar prej 60,000.00€. Pas publikimit të Njoftimit për Kontratë me datë 04.12.2023 dhe hapjes së ofertave më datë 26.12.2023, ku kishin aplikuar tre operatorë ekonomik, përfshirë edhe Operatorin Ekonomik (OE) ankues, AK rekomandon grupin e OE SAS ShPK për kontratën me një ofertë në vlerën e 56,790.53€. Megjithatë, ofertën e OE ankues, komisioni e ka vlerësuar si të pasuksesshme. Pala ankuese paraqet Kërkesën për Rishqyrtim tek AK brenda afatit ligjor, e cila më pas është refuzuar me vendim të datës 04.01.2024. OE ankues, në mosmarrëveshje me përgjigjen e AK-së, paraqet ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) më datë 11.01.2024, duke paraqitur pretendime të njëjta siç janë çmimet e ofruara dhe lista e stafit.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

1.Pretendimet operatorit ekonomik ankues "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë i Ankuesit bazohet në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe argumenton se Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur detyrimet e tij ligjore gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, duke sjellë një vendim të gabuar dhe duke mos i dhënë kërkesat e nevojshme për sqarime shtesë. Ankuesi gjithashtu argumenton se vendimi i AK-së ka rënë ndesh edhe me qëllimin e LPP-së për të siguruar integritetin, transparencën dhe drejtësinë në procesin e prokurimit publik. Në pretendimin e tij, Ankuesi përmend se AK nuk ka respektuar dispozitat e nenit 59 të LPP-së, i cili parashikon kërkesën për sqarime shtesë për tenderët në rast nevoje. Në këtë rast, AK nuk ka kërkuar sqarime shtesë, duke bërë kështu një shkelje të ligjit. Ai gjithashtu pretendon se vendimi i AK-së për të shpallur ofertën e një operatori ekonomik si fituese duke pasur gabime thelbësore në dokumentacionin e ofruar, duke u bazuar në nenin 59, paragrafi 4 të LPP-së nuk është në harmoni me LPP. Ankuesi argumenton se shkelja e procedurave dhe vendimi i gabuar i AK-së ka shkaktuar dëme dhe diskriminim për të, duke mos i dhënë mundësinë e një trajtimi të barabartë dhe të drejtë për ofertën e tij. Kështu, ai kërkon rivlerësimin e procesit të prokurimit dhe shfuqizimin e vendimit të AK-së për shpalljen e fituesit të tenderit.

Pra AK ka shpallur fitues ofertën e Operatorit Ekonomik SAS SH.P.K, ku realisht është ofertë e papërgjegjshme sepse ka gabime thelbësore në: Tabelën "Paramasa" dhe ka gabim listën e punëtorëve sipas DT-së. Tani ne shfaqim analizën tonë financiare dhe tabelën "Përshkrimi i çmimeve"(në formë screenshot) të përmbushur dhe plotësuar sipas Kërkesave dhe Kritereve të AK-së: illon me çështjen kryesore të mos përputhjes së çmimit mujor dhe total të ofertës sonë me kërkesat specifike të dosjes së tenderit. Nëse krahasohet çmimi mujor me çmimin total të llogaritur sipas rregullores së tenderit, dallohet një mos përputhje e qartë. Kjo mos përputhje mund të shkaktojë moskuptim dhe mosqartësi në vlerësimin e ofertës sonë. Në vijim, diskutohet mungesa e plotësimit të kritereve të dosjes së tenderit, veçanërisht lidhur me listën e punëtorëve. Lista e paraqitur nuk përmban numrin e duhur të punëtorëve dhe nuk plotëson kushtet e specifikuara për personelin e nevojshëm për realizimin e projektit. Tutje nga ankuesi theksohet moszbatimi i dispozitave ligjore dhe rregulloreve të prokurimit. Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka marrë parasysh shpjegimet dhe llogaritjet e detajuara në lidhje me çmimin e ofertës sonë dhe listën e punëtorëve. Kjo paraqet një moszbatim të rregullores së prokurimit publik dhe shkelje të drejtave tona si operatorë ekonomikë të përgjegjshëm.

Operatori Ekonomik ankues argumenton se Autoriteti Kontraktues (AK) ka shkelur dispozitat ligjore të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP) dhe në Rregulloren Nr.001/2022. Këto shkelje përfshijnë Nenin 1, 7, 28, 39, 59, 60, 69, 108/A të LPP-së, si dhe Nenin 39 të Rregullores Nr.001/2022.kurse duke u bazuar në të gjitha provat e bashkangjitura, kërkojnë të Aprovohet si e bazuar ankesa e tyre dhe lënda të kthehet ne, pasi qe OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm, të shpërblehen me kontrate si OE i përgjegjshëm me çmim me te lire.

2. Përgjigjet e Autoritetit kontraktues ndaj kërkesës për rishqyrtim:

Autoritetit Kontraktues (AK) pohon se kanë vepruar në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik dhe me rregulloren e caktuar për procedurat e tenderimit. Ata argumentojnë se procesi i vlerësimit të tenderit është zhvilluar në mënyrë të pavarur dhe në koordinim me komisionin e vlerësimit të tenderit. AK ka mbështetur vendimin e tyre për të dhënë tenderin Operatorit Ekonomik (OE) "SAS SHPK" për shkak të ofertës së tyre me çmimin më të ulët, dhe sepse i kanë përmbushur të gjitha kushtet e përcaktuara në dosjen e tenderit.

Në përgjigje ndaj pretendimeve të Operatorit Ekonomik ankues, AK thekson se nuk është kërkuar asnjë analizë financiare në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës. Prandaj, ata nuk janë të detyruar të kërkojnë shpjegime shtesë në lidhje me këtë çështje. Për më tepër, AK e refuzon pretendimin e OE-së ankuese se OE "SAS SHPK" ka përdorur çmime me më shumë se dy shifra dhjetore, duke argumentuar se në asnjë shifër nuk ka më shumë se dy presje dhjetore sipas dokumentacionit të paraqitur.

Në lidhje me pretendimin e OE-së ankuese për pagën neto të punëtorëve, AK paraqet llogaritjet e tyre, duke theksuar se OE "SAS SHPK" ka plotësuar kriteret e përcaktuara për pagat e punëtorëve në dosjen e tenderit. Lista e punëtorëve e paraqitur nga OE "SAS SHPK" përmbush kushtin e kërkuar për 13 punëtorë.

Në përfundim, AK konkludon se oferta e OE "SAS SHPK" është e përgjegjshme dhe më e ulët në çmim, prandaj ata e kanë propozuar si fituese të tenderit. Sipas tyre, ankimi i Operatorit Ekonomik ankues është i pa bazuar, pasi oferta e tyre është përgjegjëse, por jo më e ulët në çmim.

3. Eksperti shqyrtues lidhur me pretendimet e OE "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" - përmes raportit nr. 2024/41 ka vlerësuar si në vijim:

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me ketë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me ketë, me 31.01.2024 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa të refuzohet si e pa bazuar;
- Vertetohet Vendimi i atakuar i AK;

Raporti i ekspertizës i përmban elementet qenësore sikurse kërkohet me nenin 113, paragrafi 3 të LPP dhe i njëjti është pranuar nga të dyja palët, konform nenit 115 të LPP lidhur me nenin 20 të Rregullores së cituar. Në ketë rast evidentohet se Ankuesi nuk është pajtuar me raportin e cituar, kurse AK është deklaruar se pajtohet. Po ashtu konstatohet se palët janë në dijeni lidhur me shkresat kompletet kësaj lënde sikurse kërkohet në pajtim me paragrafin 2, të nenit 20 të të Rregullores për Punën e OSHP, Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

OE i pakënaqur me përgjigjen e AK-së me dt. 11.01.2024 ka paraqitur ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) me pretendime të njëjta. OE ankues, në ankesë ka paraparë dy pretendime ankimore të gjata, i pari ka të bëjë me çmimet e dhëna në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë duke pretenduar se ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sepse ka ofertuar me tre numra pas presjes dhjetore dhe njëkohësisht korrigjimi nga ana e komisionit nuk është bërë në përputhje me LPP-në, dhe pretendimi i dytë me listën e stafit, duke pretenduar se lista e dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit."

Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive në platformën e prokurimi sa i përket pretendimit ankimor se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së kur ka rekomanduar për kontratë OE SAS ShPK pasi që i njëjti është i papërgjegjshëm, sepse ka ofertuar me çmim jo të saktë, konsideroj se nuk qëndron. Kjo për faktin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej 2 numrave pas presjes dhjetore konform nenit 17.11 të rregullores për prokurim publik. Më tej eksperti sqaron se OE i rekomanduar për kontratë përveç se ka plotësuar përshkrimin e çmimit, i njëjti ka bashkangjitur me ofertë edhe analizën financiare të detajuar përmes të cilës vërtetohet se paga është 270.00€ neto për punëtor. OE ankues kur ka kalkuluar pagën në kalkulatorin e pagave ka përdorur çmimin e pagës bruto në vlerë prej 293.77€ kurse vlera e saktë sipas analizës financiare të dorëzuar me ofertë nga ana e OE të rekomanduar për kontratë është 293.82€ dhe nëse e vërtetojmë këtë shumë në kalkulator të pagave arrihet sakte paga minimale prej 270.00€ ashtu siç është kërkuar në dosje të tenderit. Vlen të ceket fakti se nëse i krahasojmë vlerësimet e bëra nga OE ankues, sa i përket çmimit të ofertës së tij dhe ofertës së OE të rekomanduar vërehet se te dy operatoret ekonomik në ofertat e tyre pagën bruto e kanë kalkuluar me çmimin e njëjtë në vlerë prej 293.82€ por dallimi qëndron tek kolona fitimi i kompanisë ku OE ankues ka paraparë fitim prej 0.07cent ndërsa OE i

rekomanduar për kontratë ka paraparë fitim prej 0.01cent. Ky fakt edhe e bënë dallimin në mes të ofertave të dorëzuara kurse sa i përket fitimit të kompanisë mbetet në përgjegjësinë e tyre kalkulimi i fitimit. Provë me ekspertizë do të bashkëngjisë kalkulimin e OE ankues me çmim gabim prej 293.77€ dhe kalkulimin me çmim real sipas analizës financiare të OE të rekomanduar për kontratë. Prova 1; Kalkulim i pagës bruto të OE të rekomanduar për kontratës sipas OE ankues me çmim prej 293.77€ Prova 2; Kalkulimi i pagës sipas çmimit real të paraqitur ne analizën financiare se bashku me ofertë të OE të rekomanduar për kontratë. Siç po vërehet edhe nga provat e bashkangjitura me ekspertizë, OE ankues kur ka kalkuluar pagën bruto të OE të rekomanduar për kontratë ka aplikuar çmimin prej 293.77€ i cili çmim nuk është në analizën financiare të OE të rekomanduar për kontratë. Pas kalkulimit të pagës bruto sipas vlerës së saktë të paraqitur në analizën financiare të OE të rekomanduar për kontratë vërehet se OE ka kalkuluar sakt pagën bruto në vlerë prej 293.82€ me ç'rast është përmbushur kriteri i dosjes së tenderit që paga për punëtor të jetë minimum 270.00€.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK kishte kërkuar edhe sqarime shtesë nga OE i rekomanduar për kontratë për ndryshim të çmimit të ofertës përmes të ciles oferta e OE ankues kishte ndryshuar për një cent në mes të asaj të ofertuar me atë të korrigjuar. Marrë parasyesh se ndryshimi i çmimit ishte minor dhe në përputhje me nenin 59.3 të LPP-së, pra nën 2% të vlerës së lejuar, konsideroj se AK ka vepruar në përputhje me nenin 59.3 LPP-së kur ka korrigjuar çmimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë dhe nga i njëjti kanë pranuar deklaratën e pajtueshmërisë së ndryshimit të çmimit. Andaj , vlerësojmë se pretendimi i palës në ankesë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse ka ofertuar çmim jo të saktë dhe me tre numra pas presjes dhjetore, është i paqëndrueshëm. OE ankues në pretendimin e dytë, kundërshton ofertën e OE të rekomanduar për kontratë sa i përket listës së stafit duke pretenduar se i njëjti nuk ka dorëzuar listën sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Lidhur me pretendimin e dytë ankimor Eksperti Shqyrtues sqaron se, bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive në platformën E-prokurimi, AK për këtë aktivitet të prokurimit në dosje të tenderit tek kërkesat teknike dhe profesional 9.1&9.2 kishte kërkuar si në vijim; Kërkesa; Lista e punëtorëve për realizimin e projektit Dëshmia e kërkuar; Lista e punëtorëve minimalisht 13 për zbatim projekt i nënshkruar dhe i vulosur. OE i rekomanduar për kontratë nga AK, SAS ShPK për ta përmbushur kriterin e dosjes së tenderit kishte dorëzuar listën e stafi prej 13 punëtorëve të nënshkruar dhe vulosur si në vijim; Eksperti shqyrtues sqaron se, AK në dosje të tenderit nuk kishte specifikuar as profesione të stafit apo kualifikim të caktuar, por kishte caktuar vetëm numrin minimal prej 13 punëtorëve dhe kushtin që lista të jetë e nënshkruar dhe vulosur. Siç vërehet OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e stafit prej 13 punëtorëve dhe po ashtu është e vulosur dhe nënshkruar. Pra, konsideroj se e njëjta është në përputhje me kërkesën e dosjes së tenderit. Andaj, vlerësojë se pretendimi i palës në ankesë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dorëzuar listën e stafit sipas kërkesës së dosjes së tenderit është i paqëndrueshme. Si përfundim Eksperti Shqyrtues sqaron se, AK nuk kishte nxjerr vendim për pezullimin e aktivitetit të prokurimit ashtu siç e kërkon dispozita e nenit 108A pargarafi 2 i LPP-së "Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar. Ky pretendim ankimor i palës në ankesë është pjesërisht i qëndrueshëm, por meqenëse AK nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër pas pranimit të ankesës. Andaj, konsideroj se nuk ka prodhuar ndonjë efekt negativ në procedurë mos nxjerrja e vendimit mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit, për faktin se AK e trajton si të pezulluar tashmë. Eksperti shqyrtues po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskercion të Autoritetit kontraktues respektivisht zyrtarit përgjegjës të prokurimit ZPP zbatimi i të gjitha dispozitave ligjore të parapara në LPP."

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues –

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, Paneli në ketë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit të cilat në formën e përmbledhur i prezantoi në vijim të këtij arsyetimi duke konstatuar paraprakisht se:

Bazuar në analizën e fakteve/ dëshmive të bëra nga ana e ekspertit shqyrtues në platformën e prokurimi sa i përket pretendimit ankimor, se AK sipas tij/saj ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.2 të LPP-së kur ka rekomanduar për kontratë OE SAS ShPK sepse, sepse ka ofertuar me çmim jo të saktë dhe do duhej të konsiderohej si i papërgjegjshëm, nuk qëndron , kjo për faktin se OE i rekomanduar për kontratë kishte ofertuar me çmim prej 2 numrave pas presjes dhjetore konform nenit 17.11 të rregullores për prokurim publik. Më tej eksperti ka sqaruar se OE i rekomanduar për kontratë përveç se ka plotësuar përshkrimin e çmimit, i njëjti ka bashkangjitur me ofertë edhe analizën financiare të detajuar përmes të cilës vërtetohet se paga është 270.00€ neto për punëtor. Po ashtu referuar pretendimit tjetër të ankuesit për ndryshim të çmimit, eksperti ka sqaruar se ky ndryshim ishte minor dhe në përputhje me nenin 59.3 të LPP-së, pra nën 2% të vlerës së lejuar, duke konsideruar se AK ka vepruar në përputhje me nenin 59.3 LPP-së kur ka korrigjuar çmimin e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë dhe nga i njëjti kanë pranuar deklaratën e pajtueshmërisë së ndryshimit të çmimit. Andaj, pretendimi i palës në ankesë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse ka ofertuar çmim jo të saktë dhe me tre numra pas presjes dhjetore, është i paqëndrueshëm edhe për këtë panel.

Paneli mbështet edhe arsyetimin e ekspertit lidhur me stafin profesional/teknik te OE te rekomanduar i cili ka sqaruar se AK në dosje të tenderit nuk kishte specifikuar as profesione të stafit apo kualifikim të caktuar siq pohon ankuesi, por kishte caktuar vetëm numrin minimal prej 13 punëtorëve dhe kushtin që lista të jetë e nënshkruar dhe vulosur. Siç vërehet OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar listën e stafit prej 13 punëtorëve dhe po ashtu është e vulosur dhe nënshkruar. Andaj paneli vlerëson se AK ka vepruar në harmoni edhe me nein 56.3 te LPP cituar "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Sa i përket rpetendimit se AK nuk kishte nxjerr vendim për pezullimin e aktivitetit të prokurimit ashtu siç e kërkon dispozita e nenit 108A pargarafi 2 i LPP-së , eksperti ka sqaruar se meqenëse AK nuk ka ndërmarr asnjë veprim tjetër pas pranimit të ankesës,konsideroj se nuk ka prodhuar

ndonjë efekt negativ në procedurë mos nxjerrja e vendimit mbi pezullimin e aktivitetit të prokurimit, për faktin se AK e trajton si të pezulluar tashmë. Paneli shqyrtues sqaorn se AK duhet të jenë të vëmendshëm gjatë zabtimit të procedurave të prokurimit dhe të veprojnë në harmoni me të gjitha dispozitat e LPP-së dhe Regulloreve dytësore.

Andaj pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – "Kompania e Sigurimit Fizik Scorpion" lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Sigurimi fizike e objekteve" me nr. te prokurimit: 661-23-13525-2-2-1.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

- Përfundim -

Paneli shqyrtues lidhur me vendimmarrjen për rastin konkret mori për bazë nenin 1 dhe nenin 6 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është që në një aktivitet të prokurimit AK të shfrytëzoj në mënyrë efikase parat publike duke u ndërlidhur me nenin 6 të LPP-së ku autoriteti kontraktuese janë te obliguara që fondet publike ti përdorin në mënyrë më ekonomike duke marr për bazë lenden e prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA RANILLUG**
- OE - **Kompania E Sigurimit Fizik Scorpion**
- Arkivës së OSHP-së: